



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-92179/23, më 08 MAY 2023

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, të nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës 01-020/01-194101/18, dt. 08.08.2018 dhe nenit 9 të Rregullores MF - nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-ve, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET Formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave për subvencione në Drejtorinë e Kulturës.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, anëtarë të komisionit janë:
 1. Abaz Makolli, kryesues;
 2. Selvete Shala, anëtare;
 3. Lindita Cervadiku - Dibra, anëtare;
 4. Dafina Krasniqi, (anëtare rezervë).
3. Detyrat e komisionit të cekur në pikën 2 të këtij vendimi, janë të cekura në nenin 9 dhe 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga komuna e Prishtinës 01-020/01-194101/18, dt. 08.08.2018 si dhe nenin 9 të Rregullores MF - nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-ve.
4. Mandati i komisionit të cekur në pikën 2 të këtij vendimi, është 3 vjeçar.
5. Për kryerjen e këtyre detyrave të cekura në pikën 3 të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 14-020/04-0109591/19 i dt. 14.05.2019 dhe Vendimi nr. 14-020/04-232993/22 i dt. 24.10.2022.
7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë,
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

